**VENDIM**
**Nr. 60, datë 7.7.2014**

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 9, DATË 6.2.2014, MBI NJË SHTESË NË RREGULLOREN “MBI PROCEDURAT E EMËRIMIT TË ADMINISTRATORIT DHE KOMPETENCAT E TIJ”, NË ZBATIM TË NENIT 18, PIKA 4/C TË LIGJIT NR. 9072, DATË 22.5.2003, “PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës ....7.2014, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, lidhur me kërkesën e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., për rishikimin e vendimit nr. 9, datë 6.2.2014, “Mbi një shtesë në rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., për rishikimin e “Rregullave dhe Procedurave të Blerjes së Energjisë nga KESH sh.a., si të paargumentuar.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OSSH sh.a. për vendimmarrjen e ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Petrit Ahmeti**